



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 44/09

Prishtinë, më 25.02.2009, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Besa Gaxherri, Hajdin Abazi.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Jill Jameison eksperte nga USAID-i, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 2.02.2009
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 03/ L-090 për partneritetet publike – private, koncesionet për sigurinë e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre
4. Shqyrtimi i propozim - amendamenteve te grupit punues për Projektligjin nr. 03 /L-128 për Lizingun Financiar
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 03/L-135 për Raportimet Financiare të Organizatave të Biznesit
6. Shqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/L-091 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës ne bashkëpronësi, me raportin e komisionit funksional -

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

- 8. Shqyrtimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti, Industri, Energjetik, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**
- 9. Të ndryshme.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 2 shkurt 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 2 shkurt 2009, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 03/ L-090 për partneritetet publike – private, koncesionet për sigurinë e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre

Kryesuesi, theksoi se grupi punues ka përgatitur amendamentet, me të cilat janë zgjidhur shumica e dilemave të ngritura që kishin të bënin me përcaktimin e saktë të lëndës së koncesionit, me zgjatjen e afateve. Në këtë drejtim vlerësoi ndihmën e dhënë nga Zyra e USAID-it. Çështja më diskutabile dhe e kontestueshme është propozimin amendamentit 6 që i referohet paragrafit 2.6 që parasheh të drejtën e Kuvendit që të vendos për disa çështjet më të rëndësishme që do të jenë objekt partneritetit publiko-privat apo koncesioni. Ndaj këtij propozim amendamenti ka pasur pakënaqësi nga disa, të cilët mendojnë se nëse i lehet Kuvendit të vendos, do të ngadalësoheshin procedurat e koncesionimit dhe do të rrezikoheshin investimet nga jashtë. Megjithatë për të gjetur një zgjedhje të pranueshme, kryetari propozoi një tekst të ri që e modifikon amendamentin 6, më të cilin parashihet se Qeveria merr vendim për shpalljen e interesit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet pas aprovimit paraprak formal nga Kuvendi.

Riza Smaka, duke ditur rolin e Kuvendit si institucion i pashmangshëm në funksion të legalitetit, mortalitetit dhe publicitetit, edhe në çështjet koncesioneve, roli i tij duhet të jetë i pakontestueshëm dhe vendimtar. Prandaj kërkoi që amendament e propozuara nga grupi punues të mbeten ashtu siç janë propozuara.

Besa Gaxherri, vlerësoi punën e grupit punues për propozimin e amendamenteve. Në këtë drejtim mbështet amendamentin 6 që i referohet paragrafit 2.6 me të cilin parashihet që Kuvendi të vendos për çështjet që janë objekt koncesioni, gjë që është theksoi se është edhe qëndrim i subjektit të saj politik. Një zgjedhje e tillë është në funksion të transparencës dhe është në dobi të institucioneve vendore, po ashtu edhe investitorëve të jashtëm. Se sa është në interes të përgjithshëm të vendos Kuvendi në këto çështje, kjo mund të vërtetohet nëse do të organizohet një dëgjim publik, në të cilin të gjithë të ftuarit, do të pajtoheshin për pranimin e këtij amendamenti. Me lënien e kompetencave Kuvendit, krijohen mundësitë që qytetarët të marrin pjesë direkt në procesin e dhënies me koncesion të pronave publike. Znj. Gaxherri kërkoi që ky amendament të modifikohet mirë dhe të futet në ligj.

Hajdin Abazi, duke ditur nevojat e mëdha që ka Kosova për investime dhe nevojën për hapjen e vendeve të reja të punës, theksoi duhet krijuar kushte që legjislacioni dhe procedurat të jenë fleksibile dhe të shpejta që joshin investitorët e huaj për të investuar në Kosovë. Prandaj mbështeti amendamentin e fundit të propozuar nga kryetari, sipas të cilit Qeveria vendos për objektet e dhëna

për koncesion, pas marrjes së pëlqimit paraprak nga Kuvendi. Më tutje vazhdoi duke thënë se, gjithçka duhet bërë për të joshur investitorët e jashtëm, kjo edhe për faktin se ekziston një garë e madhe në rajon për tërheqjen e investitorëve të huaj.

Haki Shatri, theksoi se nëse përkrahim propozimin e fundit që Qeveria të vendos për objektet për koncesion pas pëlqimit paraprak nga Kuvendi jemi afër zgjidhjes. Në amendamentin 6 që i referohet paragrafit 2.1 përcaktohen fushat që mund të jenë objekt partneritetit publiko-privat dhe koncesioni, andaj me miratimin e ligjit, Kuvendi vendos për çështjet e koncesionimit. Megjithatë u shpreh në pranimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim.

Kryesuesi, theksoi se lidhur me problemin në fjalë ka konsultuar disa ligje, Ligjin e Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Kroacisë, Bosnjës, Greqisë, Hungarisë, Rep. Çeke, Serbisë, tek të cilat e drejta për të vendosur për çështjen e koncesionit nuk i është lënë Kuvendit, përjashtimisht në Ligjin e Serbisë, në të cilin Kuvendi gëzon këtë të drejtë. Në këtë drejtim Serbia prin në krahasim me vendet e lartpërmendura në tërheqjen e investimeve përmes partneritetit publiko-privat dhe koncesioneve.

Xhevdet Neziraj, theksoi se secili variant i propozuar ka anët e veta pozitive dhe negative. Kjo nënkupton se nëse i lehet Kuvendit të vendos për objektet e dhëna me koncesion, mund të jetë përparësi por edhe pengesë në investime. Duke ditur përvojën jo të mirë me privatizimin, si proces i dështuar, propozoi që çështja t'i lehet për diskutim grupeve parlamentare dhe konsultimit me ekspertët, në mënyrë që vendimi i marrur të jetë i pjekur dhe në dobi të nxitjes së investimeve.

Safete Hadërgjonaj, lidhur me çështjen në fjalë, theksoi se nuk duhet vënë vetën në cilësinë e pozitës apo opozitës, sepse pozicionet politike mund të ndërrojnë ndërsa procesi i koncesionimit është afatgjatë. U pajtua me mendimin se paragrafi 2.1 parasheh fushat që janë objekt koncesioni, dhe se Kuvendi me miratimin e ligjit miraton edhe këto fusha. Theksoi se Ligji për Ndërmarrjet Publike përcakton se privatizimi i pjesëve të tyre nuk mund të bëhet pa pëlqimin e Kuvendit, andaj edhe në çështjet e koncesionimit Kuvendit duhet ta ketë rolin e vetë. Më pas kërkoi sqarim se çka është menduar në paragrafin 2.2 (i) me termin “koha e lirë”.

Kryesuesi, për sqarim njoftoi se nenin 2.6 përcakton lëndën e koncesionit, ndërsa për trajtimin e tyre e përcaktojnë nenet tjera. Ndërsa me termin koha e lirë është menduar “rekreacion”.

Naser Osmani, duke komentuar nenin 2.6, në të cilin përcaktohen fushat me interes nacional, theksoi se do të duhej të hiqeshin nga lista rrugët nacionale sepse nuk bëjnë pjesë në këtë kategori, gjithashtu të definohen qartë objektet e rëndësisë strategjike. Mbështeti idenë që Kuvendi duhet miratoj lëndët që do të jenë objekt koncesionimi. Kjo nuk do të ndikonte në dinamikën e procedurës së dhënie së objekteve për koncesion, ndërsa në anën tjetër do të rriste transparencës e punës së Qeverisë në këtë drejtim.

Myrvete Pantina, u pajtua me mendimet se kemi nevojë për procedura më të dinamike për tërheqjen e investitorëve, mirëpo mbështeti idenë që Kuvendi të ketë rolin e vetë në këtë proces, që do të lehtësonte edhe përgjegjësin e Qeverisë. Propozoj që për këtë amendament të vendos Kuvendi.

Kosara Nikolić, bëri vëreje se propozim amendamentet i ka marrë tani dhe si rezultat i kësaj nuk ka pasur kohë për konsultim me grupin parlamentar. Për këtë qëllim theksoi se nuk mund të votoj sot.

Kryesuesi, njoftoi se sot nuk do të merret vendimi, por se vetëm do të diskutohet për të gjetur zgjidhjet me të mira të mundshme.

Jill Jameison nga Zyra e USAID-it, duke u ndërlidhur me diskutimet, theksoi se qëllimi i këtij ligji është zhvillimi i infrastrukturës. Prandaj hartimi i legjislacionit dhe procedurave fleksibile ndikon në joshen investitorët që të investojnë paratë e tyre në infrastrukturën e tuaj publike. Me Ligjin për ndërmarrjet publike përcaktohet, se nëse shiten aksionet e saja duhet të merret paraprakisht vendimi i Kuvendit. Ndërsa me rastin e marrëdhënieve së partneritetit publiko-privat dhe koncesioneve nuk kemi shitje, prandaj kërkohen procedura dinamike që nxisin investitorët për të investuar këtu. Nëse mbetet amendamenti i propozuar për rolin vendimtar të Kuvendit, shfaqti brengën se do të ketë pengesa teknike dhe politike në përshpejtimin procedurave të koncesionimit. Kjo madje nuk përputhet me praktikat më të mira ndërkombëtare që ka përcaktuar UNICTRAL. Duke ditur se me Ligjin e prokurimit, janë të përcaktuara kushte dhe procedurat e tenderimit, është e panevojshme që Kuvendi të merret me këto çështje teknike, që gjithë edhe pse kalohen procedurat e prokurimit, autorizimet ekskluzive të dhëna Kuvendit, mund të paraqesin pengesë në dhënien e vendimit në proceset e dhënies së objekteve me koncesion.. Theksoi se pajtohet se ky proces të bëhet me transparencë, dhe duhet bërë brenda ligjeve ekzistente të mbikëqyrur nga organet kompetente.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Diskutimet për amendamentimin e projektligjit do të vazhdojnë në grupin punues, i cili në një afat të shkurtër do të dal me propozim-amendmanetet përfundimtare në Komision.

4. Shqyrtimi i propozim - amendamenteve te grupit punues për Projektligjin nr. 03 /L-128 për Lizingun Financiar

Kryesuesi, vlerësoi punën e grupit punues. Por njoftoi për një shkresë nga eksperti i USAID, në të cilën jepen disa vërejtje substanciale të projektligjit. Ndër të tjera potencon se projektligji ka elemente të lizingut operacionale dhe financiar, ndërsa titulli është vetëm lizing financiar. Propozoi që ti jepet një afat tri javësh këtij eksperti për të ofruar propozimet konkrete.

Naser Osmani, theksoi si grup punues kemi punuar për të bërë ndryshimet e nevojshme, kemi angazhuar edhe disa ekspert të lëmisë së caktuar. Lidhur me vërejtjet e bëra nga ekspertit USAID-it, theksoi se të njëjta çështje i kanë ngritur edhe në grupin punues në takimet e mbajtura, se projektligji përmban elemente edhe të lizingut operacionale, por se po të bëheshin ndryshime të tilla, do të ndryshohej e gjithë struktura e tij. U pajtua me propozimin për dhënien e një afati shtesë ekspertit në fjalë për të prezantuar propozimet konkrete.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni vlerësoi angazhimin dhe paraqitjen e propozim amendamentet të grupit punes.
- II. Më qëllim të rregullimit më të mirë të kësaj fushe, Komisioni shtyn miratimin e propozim amendamenteve duke dhënë një afat prej 21 ditësh ekspertit të Zyrës së USAID-it për të bërë propozimet konkrete, të cilat do të shqyrtohen dhe miratohen në Komision.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 03/L-135 për Raportimet Financiare të Organizatave të Biznesit

Kryesuesi, theksoi se Projektligji përmban shumë të meta që nuk realizon qëllimet për çka është hartuar. Këshillit Kosovar të Raportimit i lëhen në kompetencë të nxjerr rregulla dhe të modifikoj

Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Kërkoj që si komision të vendosim për kthimin apo jo të këtij projektligji sponsoruesit.

Riza Smaka, theksoi se Këshilli i krijuar me këtë projektligj nuk precizohet se a është organ ekzekutiv apo rregullativ, po ashtu nuk është precizuar se a i përgjigjet Kuvendit apo Qeverisë. Vërejtje bëri edhe për pagat e larta të parapara për anëtarët e bordit që rëndon buxhetin. Këto janë mangësi substanciale që kërkojnë kthimin e ligjit propozuesit.

Haki Shatri, theksoi se krahas vërejtjeve tona, kemi edhe dy rekomandime për kthimin e ligjit sponsoruesit sepse ai nuk përmbush standartet, prandaj të kërkojmë si Komision kthimin e tij.

Safete Hadërgjonaj, u pajtua me mendimet se problematika që rregullon ligji, nuk është rregulluar mirë, por shfaq brengën se me kthimin e tij mund të zgjatet koha e hartimit të draftit të ri. Theksoi se vërejtjet e saja janë të shumta që kanë të bëjnë me atë se ky projektligj është krijuar për interesat të shoqatës së caktuar, pastaj në procesin e trajnimeve bëhet barazimi i institucion univeristetar me shoqatën, kontabilist të çertifikuar përcaktohet se mund të jetë edhe personi pa fakultet ekonomik. Vërejtje bëri po ashtu për përdorimin e panevojshëm të termit ” kosovar”, kur dihet se të gjitha organet janë kosovare.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Komisioni pas shqyrtimit në parim, vlerësoi të nevojshëm tërheqjen e Projektligjit nr. 03/L-135 për Raportimet Financiare të Organizatave të Biznesit nga procedura e shqyrtimit të mëtutjeshme.
- II. Komisioni konstatoi se Projektligjit nuk arrin dhe nuk plotëson qëllimin që i përket nga aspekti i qartësisë, saktësisë, përmbajtjes, pajtueshmërisë me ligjet tjera dhe mundësisë së zbatimi më të lehtë të tij nga fusha e caktuar, dhe i rekomandon Kuvendit kthimin e Projektligjit sponsoruesit.
- III. Komisioni i rekomandon Kuvendit sipas rregullës 33.1 (e) të Rregullores së Punës së Kuvendit, me vendim të veçantë të udhëzojë Qeverinë që në afatin sa më të shpejtë të hartoj draft-projektligjin dhe Standartet Kosovare të Kontabilitetit të cilat duhet të jenë në përputhshmëri me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.
- IV. Njëkohësisht, Komisioni kërkon që Kuvendi të deklarohet lidhur me këtë rekomandim.

6. Shqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente

Kryesuesi, kërkoj nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjit nr.03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.

- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamenti nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/L-091 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës ne bashkëpronësi, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare.

Riza Smaka, vlerësoi si të rëndësishëm miratimin e këtij ligji që rregullon fushën caktuar dhe theksoi se duhet mbështetur atë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjit nr.03/L-091 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës ne bashkëpronësi dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamenti nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.

8. Shqyrtimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti, Industri, Energjetik, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për Mbrojtjen Konsumatorëve, dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti Industri, Energjetik, Transport e

Telekomunikacion, dhe ka konstatuar se amendamenti nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI